

VENDIM
Nr. 524, date 30.7.2004

**PER MASEN DHE MENYREN E KOMPENSIMIT TE QIRASE SE BANESES DHE
TE USHQIMIT TE USHTARAKEVE TE FORCAVE TE ARMATOSURA TE
REPUBLIKES SE SHQIPERISE**

(Ndryshuar me vendimin nr. 416, datë 28.6.2006)

(Ndryshuar me vendimin nr. 190, datë 11.4.2007)

(Ndryshuar me vendimin nr. 990, datë 11.6.2008)

(Ndryshuar me vendimin nr. 497, datë 8.4.2009)

(Ndryshuar me vendimin nr. 668, datë 7.8.2013)

Ne mbështetje te nenit 100 te Kushtetutës dhe te nenit 21 te ligjit nr.9210, date 23.3.2004 "Për statusin e ushtarakut te Forcave te Armatosura te Republikës se Shqipërisë", me propozimin e Ministrit te Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ushtaraku aktiv i Forcave të Armatosura (oficer, nënoficer, ushtar profesionist), që për shkak të detyrës, emërohet ose transferohet larg vendbanimit dhe nuk është trajtuar me banesë ose me kredi nga Ministria e Mbrojtjes, dhe kur ai ose ndonjë pjesëtar i familjes nuk ka banesë në pronësi në vendin e punës, përfiton kompensim për qira banese deri në tre vjet.

Masa e kompensimit të qirasë së banesës të jetë:

-70 për qind të çmimit mesatar mujor të tregut, për qira banese, të tipit garsionerë, kur është beqar ose i martuar dhe pa fëmijë;

-70 për qind të çmimit mesatar mujor të tregut, për qira banese, të tipit 1+1, kur është i martuar dhe ka një fëmijë;

-80 për qind të çmimit mesatar mujor të tregut, për qira banese, të tipit 2+1, kur është i martuar dhe ka më shumë se një fëmijë.

Çmimi mesatar i qirasë së banesës përcaktohet, çdo vit, nga Ministria e Financave dhe Ministria e Mbrojtjes¹.

2. Ushtaraku aktiv (oficer, nënoficer, ushtar profesionist), që përfiton kompensim për qira banese, duhet të paraqesë pranë strukturës ushtarake përkatëse këto dokumente:

a) Kërkesën për kompensimin e qirasë së banesës;

b) Certifikatën personale;

c) Certifikatën familjare;

ç) Kontratën e qirasë së banesës, të noterizuar;

d) Vërtetimin përkatës, se nuk është trajtuar me banesë apo me kredi nga Ministria e Mbrojtjes;

dh) Vërtetimin përkatës se ai/ajo ose pjesëtarët e familjes, nuk kanë banesë në pronësi.

Këto dokumente rifreskohen çdo vit².

3. Ushtaraku aktiv i Forcave te Armatosura (oficer, nënoficer dhe ushtar profesionist), i emëruar jashtë vendbanimit, i cili nuk e ka ndryshuar vendbanimin familjar, pasi nuk ka pasur mundësi strehimi, dhe nuk përfiton kompensim për qira banese, gëzon te drejtën e

¹ Ndryshuar me pikën 1/a, të vendimit nr. 497, datë 8.4.2009

² Ndryshuar me pikën 1/b, të vendimit nr. 497, datë 8.4.2009

trajtimin me ushqim ose të kompensimit në vlerë të këtij ushqimi, për tri vakte, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet vendimit nr.88, datë 28.1.2008 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e normave të trajtimit me ushqim të efektivave ushtarake të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë"³, të trajtimit me ushqim të efektivave, për ditët efektive të punës⁴.

4. Ushtaraket e tjerë të shërbimit aktiv gëzojnë të drejtën e trajtimit me ushqim ose të kompensimit në vlerë për ushqim, vetëm për vaktin e drekës, sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet vendimit nr.88, datë 28.1.2008 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e normave të trajtimit me ushqim të efektivave ushtarake të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të trajtimit me ushqim të efektivave, për ditët efektive të punës⁵.

4/1. Përzgjedhja e formës së kompensimit për efektivat e reparteve ushtarake, sipas pikave 3 e 4 të këtij vendimi, përcaktohet me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes.⁶

5. Masa e vlerës për kompensimin e ushqimit përcaktohet, çdo vit, nga Ministri i Mbrojtjes, në bazë të çmimeve mesatare vjetore, sipas buletinit të Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit⁷.

6. Kur ushtaraku thirret në repart për nevojë shërbimi (gatishmëri, stërvitje, fushime) trajtohet me ushqim të gatuar sipas normës së repartit dhe nuk përfiton kompensim në vlerë⁸.

7. Vendimi nr.505, datë 24.10.1994 i Këshillit të Ministrave "Për trajtimin me ushqim të kuadrove ushtarake aktive, që shërbejnë në strukturat e ushtrisë", i ndryshuar, nuk zbatohet për ushtaraket e Ministrisë së Mbrojtjes⁹.

8. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

9. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Financave të nxjerrin udhëzimin përkatës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

³ Ndryshuar me pikën 1/a, të vendimit nr. 990, datë 11.6.2008

⁴ Shfuqizuar me pikën 3, të vendimit nr. 668, datë 7.8.2013

⁵ Shfuqizuar me pikën 3, të vendimit nr. 668, datë 7.8.2013

⁶ Shfuqizuar me pikën 3, të vendimit nr. 668, datë 7.8.2013

⁷ Shfuqizuar me pikën 3, të vendimit nr. 668, datë 7.8.2013

⁸ Shfuqizuar me pikën 3, të vendimit nr. 668, datë 7.8.2013

⁹ Shfuqizuar me pikën 3, të vendimit nr. 668, datë 7.8.2013